



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM

Nr. 33, datë 27.01.2021

**“MBI VERIFIKIMIN E PASURISË DHE FIGURËS TË KANDIDATIT
Z. ERVIS ALLIAJ PËR T’U PRANUAR NË PROGRAMIN E FORMIMIT FILLESTAR
TË SHKOLLËS SË MAGJISTRATURËS, PËR
VITIN AKADEMIK 2020-2021**

Bazuar në nenin 149/a, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në pikën 1, të nenit 159 dhe pikën 1, të nenit 189, të Ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në nenin 32, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, germa “a”, të pikës 8, të Seksionit Ç, të Kreut VI, të Rregullores “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore për rekrutimin, emërimin si magjistrat dhe caktimin në pozicion të kandidatëve për prokurorë, si dhe zhvillimin e karrierës së prokurorëve”, e ndryshuar, e miratuar me Vendimin nr. 171, datë 27.9.2019, të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, si dhe pasi u njoh me Relacionin e Komisionit të Vlerësimit të Veprimtarisë Etike dhe Profesionale “Mbi verifikimin e pasurisë dhe figurës të z. Ervis Alliaj, kandidat për t’u pranuar në programin e Formimit Fillestar të Shkollës së Magjistraturës në vitin akademik 2020-2021”, Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

V E N D O S I:

1. Të konsiderojë të përfunduar procedurën e verifikimit të pasurisë dhe figurës së kandidatit z. Ervis Alliaj për t’u pranuar në Programin e Formimit Fillestar të Shkollës së Magjistraturës në vitin akademik 2020 -2021”, sipas relacionit bashkëlidhur.
2. Lejimin e kandidatit z. Ervis Alliaj për t’u pranuar në Programin e Formimit Fillestar të Shkollës së Magjistraturës në vitin akademik 2020 -2021”.
3. Të njoftohet për këtë vendim z. Ervis Alliaj dhe Shkolla e Magjistraturës.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit.

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

KRYETAR
GENT IBRAHIMI

ZV/KRYETARI
ALFRED BALLA



ANËTAR
KOSTAQ BELURI



ANËTAR
SANDËR BECI



ANËTAR
BUJAR SHESHI



ANËTAR
VATË STAKA



ANËTAR
ESMERALDA KESHI



ANËTAR
NURIHAN SEITI



ANËTAR
TARTAR BAZAJ



Kendi